

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [AKTUALITET](#)
- [POLITIKË](#)
- [KRONIKA](#)
- [EKONOMI](#)
- [SOCIALE](#)
- [DENONCIM](#)
- [STIL](#)
- [SPORT](#)
- [TECH](#)
- [KULTURE](#)
- [BLOG](#)
- [LIVESTREAM](#)



English
English

E fundit!

x

10:31 Aktualitet

Ergys Agasi ishte një person që kishte lidhje politike por...

Shkëlqimi dhe rënia e Agasit, me Vlora Hysenin në krye të SHISH



27 Shtator 2026, 10:31, Aktualitet CNA



Ergys Agasi ishte një person që kishte lidhje politike por që i ishte dhënë një pushtet shumë i madh, i deleguar aq sa të ishte një kryeministër i vendit.

Me heqje ministrash, vendosje drejtorësh, me kreun e Policisë së Shtetit në krah dhe mbështetjen e fortë të Vlora Hysenit në SHISH, shkëlqimi i Ergys Agasit ishte në rritje.



Si u emëruan krerët e institucioneve, pas ardhjes së Vlora Hysenit në SHISH

Lidhjet e tij të tjera vetëm forcoheshin, me SPAK që zbuloi se ai vazhonte të komunikonte me Vlorë Hysenin, komunikime ka pasur dhe me drejtues të lartë të Policisë së Shtetit.

Pritet të shohim dhe rolin e Ilir Prodës në lidhje me të, por dhe me zyrtarë të tjerë të cilët kanë qenë intensiv në komunikime me Agasin, ky i fundit një nga njerëzit që pas arrestimit të Erion Veliajt filloi të angazhohej fort për lirimin e këtij të fundit.



Hapet kasaforta e mesazheve/ Gazetari Fundo: Komunikimet e Agasit shkojnë deri te Veliaj

Tek Agasi nuk shkonin vetëm drejtorë dhe zyrtarë, por dhe biznesmenë afër tij që shkonin tek ai për të zgjidhur probleme të ndryshme me institucione të ndryshme.

Shkërmotja e Ergys Agasit nisi pas një hetimi të shpjetë të SPAK në lidhje me kontrabandën e cigareve, ku asokohe edhe ai vetë reagoi duke thënë se ishte i hapur ndaj SPAK dhe për hetimet ndaj tij.

Por pas këtij hetimi, ai i radhës ishte një goditje më e fortë për Agasin, që lidhej me skandalin e AKSHI-t, e sjellë nga Agjencitë partnere siç janë gjermanët.

Emri i Agasit ishte bërë shumë i madh, por dosja e AKSHI-t e goditi rëndë pushtetin e tij sa që menjëherë largohet nga vendi.



Si u kryqëzuan fatet e Vlora Hysenit me Ergys Agasin

Sipas informacioneve që u dhanë në atë kohë u largua në Zvicër dhe prej disa muajsh ai ka hyrë në Shqipëri ku flitej se qarkullonte rëndom në aksin Durrës-Elbasan ku dhe u arrestua në Golem në gusht të 2026 disa muaj pasi ishte larguar njeriu i tij nga Policia e Shtetit.

Pra, pasi u largua Ilir Proda nga detyra në mars të 2026 dhe në krye të policisë erdhi Skënder Hita, 6 muaj më pas u arrestua Ergys Agasi.



Arrestohet Ergys Agasi

Në momentin e ndalimit të tij bashkë me ish-efektivin Uljan Shpataraku, u sekuestruan disa telefona dhe janë zbrëthyer në kohë të shpejtë.

Nga këta telefona janë nxjerrë skemat e përdorura, komunikimet e Agasit me drejtuesen e SHISH dhe me zyrtarë të tjerë si rasti i Ilir Prodës.




Ekskluzive/ Si u zbrëthye Vlorë Hyseni nga Ergys Agasi

SPAK vazhdon hetimet dhe pritet në ditët në vijim të ketë dhe persona të tjerë nën akuzë./ CNA

- **Si u emëruan krerët e institucioneve, pas ardhjes së Vlora Hysenit në SHISH**
- **Si u kryqëzuan fatet e Vlorë Hysenit me Ergys Agasin**
- **“SHISH, në shërbim të bandave”/ Ja kush e ndihmonte Ergys Agasin për të përgjuar kë donte**
- **Skandali Hyseni-Agasi/ Kush e përgënjeshtroi valën e "fake news"-eve?**
- **Ish-shefja e SHISH nuk shantazhoi median, por kërcënoi armiqët e saj**
- **Zyrtarët e lartë dhe krimi i organizuar u bënë njësh në mbrojtje të Ergys Agasit**
- **Kush është Kryeministër në Shqipëri?**
- **Fshati digjet, këta krihen**
- **Skema kriminale/ Shefi i Policisë Shkencore ia kalonte informacionet Agasit**
- **Komunikimet e Agasit dhe Vlorë Hysenit/ Gazetari ngre alarmin: Sot ka rënë shteti**
- **Detaje tronditëse/ Shefi i Laboratorit ka futur në telefonin e Ilir Prodës një aplikacion që fshin të dhëna**
- **"Të gjithë në Tiranë kalonin nga zvrë e tii"/ Elvi Fundo zbulon zanafillën e hetimeve ndaj Ergys Agasit**

-
- Hapet kasaforta e mesazheve/ Gazetari Fundo: Komunikimet e Agasit shkojnë deri te Veliaj
 - "Dilte nga Shqipëria kur ishte në arrati"/ Gazetari Fundo: Historitë e Agasit nuk fillojnë dhe nuk mbarojnë me Hysenin
 - Zbulohet ushtari i Vlora Hysenit në SHISH, ja në cilin lokal takohet me Agasin
 - "Kasaforta" e skandaleve dhe marrëdhënia e Vlora Hysenit me Ergys Agasin
 - Ekskluzive/ Si u zbërthye Vlora Hyseni nga Ergys Agasi
 - "Krejt këta njerëz, dua që të paguajnë"/ Me kë është e mllefosur Vlora Hyseni?
 - Jo vetëm bashkëpunëtor, Ergys Agasi merrte dhe diktonte informacionin
 - "O shpirt, sa shumë gjëra na kanë bërë"/ Bisedat e Hysenit para arrestimit të Agasit: Situatë që do t'ia hedhim
 - "Më thirri me u taku të hënën"/ Skënder Hita, në komunikimet Agasi-Hyseni
 - "Çfarë na bënë o Zot"/ Vlora Hyseni i tregon Agasit takimin me Ramën: 1 orë, nuk rri më shumë me të
 - EKSKLUZIVE/ Biseda private në aplikacionin "Signal", Hyseni dhe Agasi 508 telefonata dhe video
 - Zbardhen komunikimet mes Hysenit dhe Agasit/ Si e informonte për takimet me Kryeministrin dhe zyrtarë të tjerë
 - EKSKLUZIVE/ Në makinë iu gjetën diagrame me të dhëna nga SHISH, Agasi: I lashë t'i gjente SPAK-u
 - "Zemër, duhet të koncentrohemi. Do përfundojmë keq, shpirt"/ Zbardhen mesazhet Hyseni-Agasi
-





Të sugjeruara

“Asnjë takim bilateral”/ Zhupa: Rama i refuzuar në OKB!

E Diela e I e Llukait/ Kryepiskopi Joan: Bota ka nevojë për dritë shpirtërore

Një vit nga fronëzimi i Mitropolitit të Korçës, Hirësisë së Tij Anastas

Kur do të kërkojë falje Veliaj për mashtrimet prej 405 ditësh?

Gara “Tiranathlon”/ Ja akset që do të bllokohen sot në kryeqytet

Nesër gara “Tiranathlon”/ Ja akset që bllokohen në kryeqytet

Tragjedia me 3 viktima shqiptare në Athinë/ Reagon Ministria: Pikëlluese

“UÇK, jo në emrin tim”/ Protestë dhe solidarizim në ndeshjen me Bjellorusinë

“Jep dorëheqjen sa më parë”/ Dita e 119-të e protestës, qytetarët i bëjnë thirrje Ramës

PAMJE-Atmosferë kuqezi para sfidës me Bjellorusinë/ Tifozë shqiptarë edhe nga diaspora

“Rama nuk u ndikua”/ Gazetari paralajmëron ngjarje të reja nga skandali i SHISH-it: S’kemi parë gjë akoma

Gazetari zbulon detajet: Vlora Hyseni dhe Ergys Agasi u njohën në Kryeministri

Shqipëria nënshkruan konventën e OKB-së kundër krimit kibernetik

“Kam shumë për të thënë...”/ Rikthehet Saimir Tahiri

Si u emëruan krerët e institucioneve, pas ardhjes së Vlorë Hysenit në SHISH

Si u kryqëzuan fatet e Vlorë Hysenit me Ergys Agasin

Berisha: Provat direkte më të mëdha i kam për Edi Ramën, por SPAK nuk guxon ta thërrasë

Dita e emrit të Kryepiskopit Joan, mesazhi i Fortlumbturisë së Tij: Duajeni njëri-tjetrit

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.